



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 148 /2024  
Datë: 13 shkurt 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 7 të Rregullores Nr.06/2020 për Zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit Prokurorial, në takimin e mbajtur me datë 13 shkurt 2024, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Themelohet Komisioni Zgjedhor i Këshillit Prokurorial të Kosovës për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin prokuror të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë Speciale, në këtë përbërje:
  1. Arian Gashi, Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës - Kryesues;
  2. Agron Qalaj, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit- Anëtar;
  3. Sami Istrefi, Drejtor i Sekretariatit të KPK-së- Anëtar
- II. Anëtarë rezervë të Komisionit Zgjedhor të Këshillit Prokurorial të Kosovës janë:
  1. Veton Shabani, Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
  2. Lulzim Sylejmani, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
  3. Arta Kelmendi, Drejtor i NJSHPP-së
- III. Obligohet Komisioni Zgjedhor që veprimtarinë e tij ta ushtrojë në bazë të Rregullores Nr.06/2020 për Zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit Prokurorial.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.